



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL
AUTORITETI KOMBËTAR I USHQIMIT
DREJTORIA E SHËRBIMEVE TË BRENDSHME

Nr. 3457 Prot.,

Tiranë, më 26.06 2026

SHPALLJE PËR VENDE TË LIRA PUNE
NË
DREJTORINË E PËRGJITHSHME TË AKU-SË

Në mbështetje të ligjit nr. 7961, datë 12.7.1995 “Kodi i Punës në RSH”, i ndryshuar, neni 19, pika 1 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative në RSH”, ligjit nr.9863, datë 28.1.2008 “Për Ushqimin”, i ndryshuar, ligjit nr. 90/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”, i ndryshuar, në VKM-në nr. 708, datë 9.9.2020 “Për organizimin dhe funksionimin e Autoritetit Kombëtar të Ushqimit”, Urdhrit të Kryeministrit nr. 7, datë 10.01.2025 “Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Autoritetit Kombëtar të Ushqimit”, Rregullores së Brendshme për organizimin dhe Funksionimin e Autoritetit Kombëtar të Ushqimit, të miratuar me Urdhrin nr. 297, datë 23.6.2022 të Ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Manuali i Rekrutimit (i ndryshuar),

1. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit shpall 1 (një) pozicion të lirë pune në Drejtorinë e Përgjithshme të AKU-së, si vijon:

A) 1 (një) pozicion të lirë pune “*Përgjegjës*” në Sektorin e Shërbimeve Laboratorike Tiranë në Drejtorinë e Vlerësimit të Riskut.

B) Kriteret e veçanta për vendet e shpallura vakante:

Për pozicionin “*Përgjegjës*” në Sektorin e Shërbimeve Laboratorike Tiranë në Drejtorinë e Vlerësimit të Riskut, kategoria III-3.

Arsimi: Të zotërojë diplomë të nivelit “Master i Shkencave” ose “Master profesional të përfutur në fund të studimeve të ciklit të dytë me 120 kredite dhe me kohëzgjatje normale 2 (dy) vite akademike” ose të barazvlefshme me to, në fushat e kërkuara:

Mjekësi Veterinare/ Mikrobiologji/ Bioteknologji Ushqimore/Shkencat dhe Teknologjitë Ushqimore/ Inxhinieri Agrare në profilet Hortikulturë - Mbrojtja e Bimëve - Prodhim Bimor – Zootekni - Zootekni dhe Siguria e Produkteve Blegtorale–Akuakulturë-Shkencat

Agronomike/ Bioteknologji Molekulare dhe Industriale/Kimi/ Biologji/ Biologji-Kimi ose në fusha të tjera që përshtaten me pozicionin e shpallur vakant.

(Edhe diploma e nivelit "Bachelor" duhet të jetë në të njëjtën fushë).

**Diplomat të cilat janë marrë jashtë vendit, duhet të jenë njohur paraprakisht pranë institucionit përgjegjës për njehsimin e diplomave, sipas legjislacionit në fuqi.*

Përvoja:

- Të ketë të paktën 3 vite eksperiencë pune në Profesion;
- Të ketë njohuri shumë të mira të specialitetit brenda fushës profesionale, sipas veprimtarisë që mbulon drejtorinë/sektorin;
- Të ketë njohuri të mira të procedurave administrative; aftësi për të përcaktuar objektivat, vendosur prioritete dhe respektuar afatet; aftësi për të shqyrtuar, verifikuar dhe vlerësuar;
- Të ketë njohuri të përdorimit të programeve bazë kompjuterike;
- Preferohet të ketë njohuri të mira të gjuhës angleze/ të huaja.

C) Kriteret e veçanta për vendet e shpallura vakante

Personat e interesuar duhet të plotësojnë këto kriteret të përgjithshme:

- Të jetë shtetas shqiptar;
- Të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
- Të zotërojë gjuhën shqipe, të shkruar dhe të folur;
- Të jetë në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryejë detyrën përkatëse;
- Të ketë integritet të lartë profesional e moral;
- Të mos jetë i/e dënuar me vendim të formës së prerë të gjykatës;
- Të mos jetë përjashtuar/shkarkuar nga administrata publike;
- Të ketë aftësi të mira komunikimi dhe prezantimi.

D) Rregullat mbi mënyrën, afatin e dorëzimit të aplikimeve dhe kualifikimin e kandidatëve:

1. Personat e interesuar duhet të dorëzojnë CV dhe dokumentacionin përkatës si vijon:

- Kërkesë për punësim;
- Jetëshkrim;
- Fotokopje të diplomës të noterizuar me origjinalin;
- Fotokopje të librezës së punës (të gjitha faqet që vërtetojnë eksperiencën në punë);
- Fotokopje të letërnjoftimit (ID);
- Vërtetim të gjendjes shëndetësore;
- Vetëdeklarim të gjendjes gjyqësore;
- Vetëdeklarim të mos jetë përjashtuar/shkarkuar nga administrata publike.

Shënim: Mosdorëzimi i dokumenteve të mësipërme dhe mosplotësimi i kriterëve, e s'kualifikojnë automatikisht aplikantin.

2. Dorëzimi i dokumentacionit do të bëhet brenda 7 ditëve kalendarike nga data e shpalljes në faqen zyrtare www.aku.gov.al nëpërmjet adresës së email bnjz.aku@aku.gov.al.

3. Aplikimet pranohen nga data 29.06.2026 deri në datë 05.07.2026 përfshirë të dyja

4. Brenda 1 (një) dite pune struktura përgjegjëse për burimet njerëzore pas verifikimit të dokumentacionit të dorëzuar nga kandidatët, mban procesverbal evidentues mbi mangësitë ose jo në dokumentacion dhe kryen shpalljen në faqen zyrtare www.aku.gov.al të njoftimit për kandidatët e përzgjedhur.
5. Çdo kandidat ka të drejtën për ankim jo më vonë se 24 orë nga shpallja e njoftimit.
6. Njoftimi dhe komunikimi me kandidatët, do të bëhet nëpërmjet numrit të telefonit ose adresës së postës elektronike të deklaruar.
7. Struktura e Burimeve Njerëzore është përgjegjëse për ndjekjen dhe zbatimin e procedurave të rekrutimit dhe hartimin dhe arkivimin e dokumentacionit përkatës.

DREJTOR I PËRGJITHSHËM

BLERINA GJYLAMETI

